



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

12 qershor 2015

## AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

**Në AKP u organizua një takim i përbashkët ndër institucional në pritje të delegacionit Gjerman në fushën e resurseve minerare e më theks të veçantë mbështetje për ndërmarrjen Trepça**



**Prishtinë** - Agjencia Kosovare e Privatizimit, priti sot në një takim përfaqësuesit e Ministrisë Federale për çështje Ekonomike dhe Energji, me prezencën edhe të Ambasadores Gjermane në Prishtinë, zonjës Angelika Viets, përfaqësues dhe ekspertë të organizatës qeveritare gjermane GIZ në Kosovë.

Pritjen e karakterizoi koordinim i lartë institucional i akterëve kyçë, në fushën minerare. Në pritjen e Delegacionit Gjerman të organizuar nga AKP, morën pjesë përfaqësues të institucioneve relevante të Kosovës në këtë fushë, respektivisht: MZhe në krye me Zëvendës Ministren, z. Besa Zogaj - Gashi si dhe

Drejtori i Departamentit të Minierave të kësaj Ministrie, Bordi dhe Menaxhmenti i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), Përfaqësues të Shoqatës së Gjeologëve të Kosovës, Drejtori i Departamentit të Mjedisit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit (MMPH), si dhe Menaxhmenti i “Trepçës”.

Takimi u mbajt në vazhden e bashkëpunimit me shtetin Gjerman, që përmes ekspertëve në fusha të caktuara kanë ofruar dhe ofrojnë mbështetje për AKP dhe institucionet tjera relevante në Kosovë në fushën e resurseve minerare, e më theks të veçantë mbështetje për ndërmarrjen Trepça.

Të gjithë të pranishmit patën rastin dhe prezantuan mundësitë e bashkëpunimit në fusha të caktuara, e posaçërisht në valorizimin dhe trajtimin e rezervave minerare të cilat Republika e Kosovës i posedon. Përveç prezantimit të potencialit të rezervave dhe potencialet tjera minerare të Kosovës, në takim u dhanë shpjegime për legjislacionin fleksibil dhe liberal i cili aplikohet në fushën minerare.

Në takim përveç prezantimeve dhe diskutimeve u shkëmbyen edhe informata të rëndësishme ndërmjet palëve të cilat janë motivuese për konkretizim të bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe shtetit Gjerman.

AKP si nikoqire e këtij takimi, përmes ushtruesit të detyrës së zëvendës drejtorit menaxhues z. Avni Jashari, i informoj të pranishmit për rolin dhe përgjegjësinë e AKP si Administratore e ndërmarrjes Trepça, por edhe informata të përgjithshme për procesin e Privatizimit në Kosovë me theks të veçantë në sektorin minerar dhe për sigurimin e lëndëve të para. Z. Jashari shprehi falënderimin dhe mirënjohjen për Përfaqësuesit e Delegacionit Gjerman dhe institucioneve publike të Kosovës, për përkrahjen e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në ushtrimin e mandatit të saj.

Zëvendës Ministria e Zhvillimit Ekonomik, z. Besa Zogaj - Gashi, përshëndeti takimin dhe të gjithë pjesëmarrësit e sektorit minerar në Kosovë, zv. Ministria vlerësoi mbështetjen e Ambasadaes Gjermane dhe GIZ-it në zhvillimin ekonomik të Kosovës duke shpresuar në thellimin dhe konkretizimin e bashkëpunimit të mëtejshëm me përfaqësuesit e Ministrisë Federale Gjermane të Ekonomisë.

Zëvendës Ministria shprehu falënderimin për vizitën dhe gatishmërinë për përkrahje të projekteve të cilat zgjojnë interes të dyanshëm.

Në fund të takimit, Ambasadorja Viets cilësoi organizimin në nivel duke falënderuar të gjitha palët prezente për kontributin e tyre në këtë takim, duke shprehur gatishmërinë që të jep përkrahjen e duhur për realizimin e ideve të shprehura këtu për një bashkëpunim konkret i cili do të rezultonte në investime të reja dhe vende të reja të punës në një të ardhme të shpejtë.

Në fund të takimit, grupi ndër-institucional doli me disa konkluzione ndër të cilat:

- Duhet të rregullohet infrastruktura ligjore dhe të definohen mirë çështjet pronësore për realizimin e projekteve të cilat kanë potencial të madh për sukses.
- Pas pranimit të informatave të shumta, Ministria Federale Gjermane për çështje Ekonomike dhe Energji ku do të analizojë të njëjtat, dhe me gjasë do të identifikohen disa pika me interes të përbashkët dhe se për këto pika të radhës do të diskutohet bashkërisht me palën Kosovare në Berlin.
- Do të shqyrtohet mundësia për mbështetje me trajnim dhe edukim për nevojat e sektorit minerar, sidomos në trajnimin e ekspertëve vlerësues të rezervave minerare sipas standardeve ndërkombëtare të pranuar.